REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

| Pranuar-Primljeno Me Datë | 18-08-2026 | | |
|---|---|---|---|
| Nr. Lorgan.it Org. Broj | Numri Broj | Shtojce Prilog | Vlera Vrednost |
| 01- | 060 | 01-836 | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 53, të Ligjit Nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 44, 45 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komiteti për Komunitete bënë këtë:

# F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **-VII-**, të rregullt të Komitetit për Komunitete, që do të mbahet me datë **17.08.2026** duke filluar në ora **11:00h.**
Mbledhja do të mbahet në sallen e konferencave të Komunës së Vitisë.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

## R e n d   d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Komunitete**
2. **Siguria në shkollat e Komunës së Vitisë.**
3. **Të ndryshme.**

Mbledhja është e hapur për publikun.

Viti, 13.08.2026,
Me respekt,

Kryetari i Komitetit për Komunitete
z.Nenad Ilic
N. Ilic
_______________________

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

| Pranuar/Primljeno Me/Dana | 14-08-2026 | | |
|---|---|---|---|
| Nr. Lorganit / Org. Broj | Numri/Broj | Shtojca/Prilog | Vlera/Vrednost |
| 07 | 060 | 07 | 836 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Na osnovu člana 53, Zakona br.03-L-040 za Lokalnu Samoupravu (Službeni list Republike Kosova br.28/15, Jun 2008) i člana 44, 45 Statutom Opštine Vitina br.01-013/491, datuma 21.04.2011, predsedavajući Komiteta za Zajednice donosi sledeće:

# P O Z I V

Pozivate se na učešću -VII- redovne sednice Komiteta za Zajednice, koja će biti održana dana **17.08.2026**. sa početkom u **11:00 časova**.
Sednica će biti održana u konferencijskoj sali Opštine Vitina.

Za predstojeću sednicu predsedavajući predlaže sledeće:

## D n e v n i  r e d

1. **Razmatranje i usvajanje zapisnika sa šeste sednice Komiteta za Zajednice.**
2. **Bezbednost u školama Opštine Vitina.**
3. **Pod razno.**

Sednica je otvorena za javnost.
S poštovanjem!

Vitina, 13.08.2026.godine

Predsednik Komiteta za Zajednice
Nenad Ilić
N. Ilić

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

# PROCESVERBAL
## NGA MBLEDHJA E GJASHTË E RREGULLT E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Është mbajtur mbledhja e –VI- e rregullt e Komitetit për Komunitete të Komunës së Vitisë. Mbledhjen e ka thirrur dhe e ka kryesuar, z.Nenad Ilić. Mbledhja është mbajtur në sallën e konferencave në objektin e ri të Komunës së Vitisë, më datë 18.06.2026, me fillim në orën 11:00. Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi z.Nenad Ilić, z.Rifat Aniqi, znj.Kata Pala, znj.Djellza Fejzullahu, z.Visar Demiri, z.Elhami Emërllahu dhe z. Sasa Ristic, përfaqesuesi i UNMIK-ut. Ndërsa mungoi: Sanja Dajic-Vasic.

**z.Nenad Ilić:** Të nderuar kolegë, anëtarë të Komitetit, përfaqësues të organeve komunale, mirëdita të gjithëve. Hap mbledhjen e gjashtë të Komitetit për Komunitete, duke konstatuar se ekziston kuorumi për mbajtjen e kësaj mbledhjeje. Për mbledhjen e sotme të Komitetit për Komunitete kam propozuar këtë rend dite:

### RENDI DITËS

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit për Komunitete.**
2. **Shqyrtimi i mosfunksionimit të sistemit të përbashkët të ngrohjes në të dy shkollat me mësim në gjuhën shqipe dhe serbe në fshatin Binçë.**
3. **Të ndryshme.**

A ka propozime për ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, apo pajtoheni që rendi i ditës të jetë kështu siç është? Nëse nuk ka propozime për ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, e vë rendin e ditës në votim për miratim. Kush është për? Konstatoj se rendi i ditës u miratua njëzëri.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit për Komunitete**

Materialin e keni pranuar me kohë në grupin e Viber-it, kështu që secili prej nesh ka pasur mundësi ta shikojë dhe ta lexojë procesverbalin. Nëse keni ndonjë vërejtje lidhur me procesverbalin, mund t'i paraqisni ato, ose mund të votojmë për miratimin e këtij procesverbali. A jeni për miratimin e procesverbalit? Konstatoj se procesverbali u miratua njëzëri. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

**Pika e dytë e rendit të ditës:**

**2.Shqyrtimi i mosfunksionimit të sistemit të përbashkët të ngrohjes në të dy shkollat me mësim në gjuhën shqipe dhe serbe në fshatin Binçë.**

**z.Nenad Ilic:** Unë jam propozuesi i kësaj pike të rendit të ditës, prandaj do të doja t'ju njoftoja me problemin që ekziston lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Në fshatin Binçë, shkolla ku vijojnë mësimin fëmijët në gjuhën shqipe dhe shkolla ku vijojnë mësimin fëmijët në gjuhën serbe ndodhen në të njëjtin oborr, që do të thotë se fëmijët e të dyja shkollave e ndajnë një oborr shkollor. Në njërin objekt shkollor, në bodrumin e objektit, është instaluar një sistem i ngrohjes qendrore, i cili është i lidhur me të dyja shkollat. Sistemi është instaluar para më shumë se 7–8 vjetësh dhe është përdorur vetëm një sezon. Sipas vlerësimit tim, ky sistem ka vlerë rreth 10.000 euro. Ka një kaldajë me kapacitet shumë të madh dhe gjithçka është në gjendje shumë të mirë. Besoj se ka qenë një lloj donacioni. Megjithatë, pas atij sezoni sistemi ka pushuar së përdoruri, me arsyetimin, siç kanë thënë personat që merren me ngrohjen, se sistemi diku lëshon ujë, përkatësisht lëng, dhe për këtë arsye nuk është i përshtatshëm për përdorim. Më pas, punëtorët e shkollës, përkatësisht personat përgjegjës për ngrohjen, kanë kaluar në një sistem ku në çdo klasë kanë nga një shporet. Këto janë shporeta të vjetërsuar. Vajza ime vijon mësimin në njërën prej këtyre shkollave, por edhe në shkollën shqipe situata është e njëjtë. Shporetat janë shumë të vjetërsuar, ndërsa oxhaqet dhe kanalet e tymit janë në gjendje shumë të keqe, madje ka ndodhur edhe që të bien pjesë prej tyre. Kjo është vërtet një gjendje e keqe. Dhe tani kemi një situatë e cila, sipas mendimit tim, ekziston vetëm tek ne, kemi një sistem me vlerë rreth 10.000 euro, ndërsa fëmijët ngrohen në një mënyrë të vjetërsuar dhe të papërshtatshme. Nuk kam informacione nëse drejtorët e këtyre dy shkollave kanë ndërmarrë diçka lidhur me këtë çështje dhe nëse u janë drejtuar organeve komunale për të dërguar një ekip që do ta kontrollonte sistemin dhe do t'u siguronte fëmijëve ngrohje të përshtatshme, cilësore dhe të sigurt. Kjo nuk është vetëm çështje komoditeti, por edhe çështje sigurie. Mund ta shihni edhe në fotografi se në çfarë gjendjeje janë këto shporeta. Ato nxjerrin tym dhe cilësia e ajrit në klasë sigurisht që nuk është e mirë. Nëse vërtet nuk ekziston asnjë kërkesë nga ana e këtyre dy shkollave, pra nëse ato nuk i janë drejtuar Komunës dhe nuk kanë kërkuar që të kontrollohet defekti, atëherë me të vërtetë e kritikoj punën e tyre. Ata kanë drejtorët e shkollave dhe këshillat e shkollave dhe kanë mundur të reagojnë edhe para nesh. Ne jemi instanca që po reagon tani, por konsideroj se ky problem është dashur të ngrihet edhe më herët. Në përgjithësi, situata është kjo: konsideroj se defekti nuk është i tillë që nuk mund të riparohet relativisht lehtë. Këtë mund ta bëjë një ekip të cilin do ta dërgonin organet kompetente, i cili do të përcaktonte se ku është defekti dhe çfarë nevojitet për ta vënë përsëri sistemin në funksion. Vlerësimi im është se defekti nuk është aspak i madh dhe se sistemi i instaluar i cili ka një vlerë të konsiderueshme, vetëm po dëmtohet nëse nuk përdoret dhe nuk mirëmbahet. Me këtë arsyetim desha t'ia paraqes Komitetit problemin që ekziston. Tani mund të hapim një diskutim të përbashkët dhe të përcaktojmë se cilat zgjidhje mund t'i propozojmë ne si Komitet dhe cilat rekomandime mund t'i nxjerrim. A dëshiron dikush ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës?

**z.Elhami Emërllahu:** Kam punu gjatë në arsim dhe është pak punë e ndjeshme gjithmonë me nxënës dhe me shkolla. Dhe, sa unë e di, nuk ka më shkolla në Komunën e Vitisë që ngrohen me shporeta. Ka raste kur kanë pas problem herë pas here me sistemet e ngrohjes nëpër shkolla, por kanë funksionu edhe janë duke funksionu. Një pjesë janë me rrymë, një pjesë me dru, ka edhe disa që janë me naftë. Komuna e Vitisë e ka një ekip që i mbikëqyr këto apo mos është vetëm një punëtor. Unë nuk e di se si funksionon shkolla aty në Binçë, a ka drejtor shkolle apo si është?

**z.Nenad Ilic:** Meqenëse arsimi në Kosovë ende funksionon si dy sisteme të ndara, ekziston një drejtor nga sistemi shqiptar dhe një drejtor i shkollës nga sistemi serb. Prandaj edhe unë po e shtroj këtë pyetje, të cilën do të doja t'ua drejtoja atyre: a i është drejtuar ndonjëherë ndonjë nga drejtorët ndonjë institucioni lidhur me këtë problem? Sigurisht që defektet në sistemet e ngrohjes ndodhin, mirëpo ky sistem ka kohë që është jashtë përdorimit. Unë kam biseduar me punëtorët që merren me ngrohjen. Për disa prej tyre është më e lehtë të ngrohin në këtë mënyrë. E dini, për të punuar si person përgjegjës për ngrohjen duhet të keni certifikata të caktuara. Madje, është e mundur që edhe punëtorët që merren me ngrohjen të mos kenë certifikatat e nevojshme.

**z.Elhami Emërllahu:** Qysh do që është tash ajo shkollë edhe që punohet me dy sisteme, pavarësisht asaj, po mendoj që Komuna veç e paska bërë sistemin, ajo duhet me rregullu, ata janë qytetarë të Komunës së Vitisë, qoftë serbë qoftë shqiptarë.

**z.Nenad Ilic:** Nuk jam i informuar se ka ardhur ndonjë ekip. Kam punuar për një periudhë të caktuar në njërën prej këtyre shkollave dhe kam biseduar për këtë çështje. Mirëpo, po ta shihnit kaldajën dhe sistemin, do

të shihnit se sa i mirë dhe cilësor është në të vërtetë, ndërsa fakti që nuk përdoret është vërtet për të ardhur keq. Kaldaja, sa kam vërejtur, ka kapacitet prej 70 kW, që është një kapacitet i shkëlqyeshëm për t'i mbuluar të dyja objektet. Dhe ajo qëndron në bodrum dhe nuk përdoret, si një pajisje që e vendos diku dhe me kalimin e kohës vetëm sa dëmtohet. Vetëm ta shikoni, ndoshta edhe ju si anëtarë të Komitetit mund të bindeni dhe të shihni nga afër se në çfarë gjendjeje janë kaldajat, ta shikoni sistemin, si është instaluar dhe për çfarë shërben, nëse ne kemi autorizim për t'i vizituar shkollat.

**z.Elhami Emërllahu:** Ateherë është mirë edhe ne si Komitet ta ngremë këtë problem dhe ata drejtorë të vijnë të bëjnë kërkesë në Drejtorinë e Arsimit dhe të funksionalizohet, pasi jemi në sezonin e verës, që prej shtatorit të jetë gati.

**z.Nenad Ilic:** Këtë nëse e miratojmë si rekomandim, unë si kryesues do ta drejtoj një kërkesë si te organet kompetente komunale, ashtu edhe te drejtorët e shkollave.

**z.Rifat Aniqi:** Nëse është nevoja, mund të jenë prezent edhe dy drejtorët në mbledhje dhe ta diijm se cili është problemi. Ata na tregojnë neve shumë më mirë se cili është problemi.

**z.Nenad Ilic:** Ajo që kam vërejtur është se këto dy shkolla funksionojnë në një ambient të shkëlqyer dhe përdorin të njëjtin podrum për dru. Nuk ka rëndësi se nga vijnë drutë dhe as kush i blen ato.

**z.Elhami Emërllahu:** Kjo po më pëlqen, se ndoshta është një rast i vetëm në Kosovë. Për të mos u kthyer te ato që kam thënë muajin e kaluar, se ajo mua më mrec kapak, nuk mund të rri, edhe me i kallëzu këtij zotërisë së UNMIK-ut që raportet, kur bëhen, të bëhen reale. Raportet për respektimin e komuniteteve në Kosovë, që komuniteti serb dhe shqiptar, pavarësisht që ai komuniteti serb punon me sistem të Serbisë, shteti ynë po i toleron edhe po ua njeh atë të drejtë, që ndoshta është elementare. Nuk po dua të hyj në politikë, por a është në rregull apo s'është në rregull të punojnë dy sisteme, ajo është çështje krejt tjetër, nuk është punë e jona. Megjithatë, na si Komitet, është mirë me ba trysni edhe ajo ngrohje të rregullohet.

**z.Nenad Ilic:** Sigurisht, kjo është minimumi. Edhe ai defekte, ne e dimë që defektet ndodhin, defektet riparohen dhe vazhdohet me funksionimin, por jo këtu. Këtu kjo gjendje vazhdon vazhdimisht. Shkolla ndodhet në një zonë kodrinore, është ftohtë edhe pas përfundimit të sezonit të ngrohjes, megjithatë atje ngrohen deri në fund të majit. Nuk kanë probleme me drutë. A dëshiron dikush tjetër ta marrë fjalën? Nëse jo, a pajtoheni që Komiteti për Komunitete, ashtu siç propozoi edhe Elhami, t'ua dërgojë një rekomandim organeve kompetente komunale dhe drejtorëve të shkollave për zgjidhjen urgjente të këtij problemi deri në fund të këtij sezoni? E marr përgjegjësinë dhe fajin mbi vete që në këtë mbledhje nuk ua kam dërguar ftesën drejtorëve të këtyre shkollave, në mënyrë që t'u parashtronim edhe atyre disa pyetje që jemi të obliguar t'ua bëjmë. A pajtoheni që t'i nxjerrim këto përfundime? Faleminderit. Pra, unë si kryesues do ta dërgoj këtë rekomandim dhe shpresoj se do të arrijmë ta zgjidhim këtë problem. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

Pika e tretë e rendit të ditës:

2. **Të ndryshme**

**z.Nenad Ilic:** Ndoshta mund të merremi vesh tani për datën e mbajtjes së mbledhjes në gusht, në mënyrë që t'u përshtatet të gjithëve për shkak të sezonit të pushimeve. Për mua nuk ka rëndësi, vendosni ju si të merreni vesh. Ndërsa rendin e ditës mund ta propozoni ju. Do t'ju lusja të jepni ndonjë propozim.

**z.Elhami Emërllahu:** Masi jemi te pika të ndryshme, a ka diçka nga kërkesa që e keni dorëzu te Drejtoria e Shërbimeve Publike për rrugën?

**z.Nenad Ilic:** Ende nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga institucionet kompetente.

**z.Elhami Emërllahu:** Edhe një çështje kisha kërkuar që këto mbledhje që mbahen të Komitetit, me rendin e ditës, të publikohen në faqen e Komunës, se këto që i diskutojmë, këto vendime që i marrim, këto propozime dhe ide, le të jenë edhe në publik. Le ta dijë Komuna dhe kryetari edhe krejt ata se çka jemi duke diskutu, çfarë qëndrimesh jemi duke marrë e çfarë kërkesa. Edhe puna e meditjeve është duke pasur probleme herë pas here, nuk e di pse, edhe këtë duhet ta sqarojmë.

**z.Nenad Ilic:** Pajtohem, është një propozim i mirë. Ne supozojmë se i dimë të gjitha problemet, por megjithatë, ndoshta dikush mund të na drejtohet me ndonjë propozim ose rekomandim për rendin e ditës, ndonjë qytetar.

**znj.Antoneta Palja:** Sa i përket pagesave, jam duke u marrë me këtë çështje, po kërkush nuk është duke më dhënë përgjigje. Problemi është që Ministria e ka dërguar një shkresë, qysh më ka thënë Fatlumi, nuk e di kujt, atij apo kryesuesit të Kuvendit, që pagesat që janë bërë prej pagave dhe mëditjeve me i heq prej atij kodi dhe me i marrë diku tjetër. Po kur e kam pyet Beqirin, të cilit ia dorëzoj listën, ai më ka thënë që duhet me apliku në eKosova, po ku, në cilën rubrikë, nuk ka dit me më tregu. E kam pyet edhe Vlorën te Financat. Ajo njëherë më ka thënë që njëri prej anëtarëve duhet me marrë përgjegjësinë me ia lëshu atij mjetet, pastaj me i shpërnda tek ju, po kjo nuk ka logjikë, sepse ata janë individualë. Edhe ia kam parashtru pyetjen se si kanë vepru me KPF-në, pasi që të dy komitetet janë komitete obligative dhe mendoj që si të veprohet me njërin, do të duhej me u vepru edhe me tjetrin në të njëjtën mënyrë. Atëherë ajo më tha: "Le të hyjnë në eKosova me apliku dhe një numër ma japin pastaj mu", po as këtë nuk ma kanë tregu se si bëhet.

**z.Visar Demiri:** Unë nuk e di, kjo është absurde. E para, këta janë trupa që zgjidhen nga Kuvendi Komunal dhe ma shumë janë tu ba dëm kështu, se është antiligjore me ia qit një personi dhe me i shpërnda. Këta duhet me kërku sqarime prej Ministrisë së Financave dhe Pushtetit Lokal. Nëse mundesh, atë kërkesën me kërku me na e dërgu në grup, me pa se ku janë thirr, në cilin ligj.

**z.Nenad Ilic:** A janë duke punuar organet komunale për zgjidhjen e këtij problemi, apo kjo është një përgjigje që vjen nga instancat më të larta dhe tani gjithçka ka mbetur kështu? Sepse ne jemi caktuar këtu nga Komuna, ne i përgjigjemi Komunës dhe për këtë arsye përgjigjet duhet t'i kërkojmë prej tyre.

**z.Elhami Emërllahu:** Disa komuna po i paguajnë vetëm asambleistët, ajo varet prej Komunës se si e rregullon. Komuna e Vitisë nuk e ka pas atë problem, na kemi marrë mëditje.

**z.Visar Demiri:** Është shkelje e të drejtave të njeriut kur dikush që e bën të njëjtën punë paguhet, ndërsa dikush tjetër jo.

**z.Nenad Ilic:** A pajtoheni që ta ftojmë ose Kryetarin e Kuvendit ose Fatlumin, në mënyrë që edhe ai të na e shpjegojë në detaje situatën dhe që së bashku me ta të nxjerrim përfundime se çfarë duhet të bëjmë?

**z.Visar Demiri:** Flas unë me kryesuesin dhe Fatlumin, nëse e kanë emailin, po e marr prej tyre.

**z.Elhami Emërllahu:** Nuk jemi veç na, edhe KPF-ja nuk janë pagu.

**z.Visar Demiri:** Është tjetër problem. Problemi është se këto mëditje janë tu na i qit prej të hyrave vetanake dhe përmbaruesi është duke i marrë. A KPF-ja janë krejt anëtarë të Kuvendit, ndërsa te ne jemi vetëm tre prej Kuvendit. Për neve nuk është problem, por për anëtarët që nuk janë pjesë e Kuvendit është problem.

**z.Nenad Ilic:** Nëse nuk ka më askush diçka për të shtuar, ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe shihemi në mbledhjen e ardhshme.

**Mbledhja përfundoj në ora 11:37.**

**Procesmbajtës:**
**znj.Antoneta Palja**

____________

**Kryesues i Komitetit për Komunitete**
**z.Nenad Ilić**

____________

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

# ZAPISNIK
## SA ŠESTE REDOVNE SEDNICE KOMITETA ZA ZAJEDNICE

Održana je –VI- redovna sednica Komiteta za zajednice opštine Vitina. Sednicu je sazvao i njom predsedavao g. Nenad Ilić. Sednica je održana u konferencijskoj sali u novoj zgradi Opštine Vitina, dana 18.06.2026. godine, sa početkom u 11:00 časova. Na sednici su prisustvovali: predsedavajući g. Nenad Ilić, g. Rifat Aniqi, gđa Kata Pala, gđa Djellza Fejzullahu, g. Visar Demiri, g. Elhami Emërllahu, g.Saša Ristić, predstavnik UNMIK-a. Odsutna: Sanja Dejić-Vasić.

**g. Nenad Ilić:** Poštovane kolege, članovi Komiteta, predstavnici opštinskih organa, dobar dan svima. Otvaram šestu sednicu Komiteta za zajednice uz konstataciju da postoji kvorum za održavanje ove sednice. Za današnju sednicu Komiteta za zajednice predložio sam sledeći dnevni red:

**DNEVNI RED**

1. **Razmatranje i usvajanje zapisnika sa pete sednice Komiteta za zajednice.**
2. **Razmatranje nefunkcionisanja zajedničkog sistema grejanja u dve škole sa nastavom na albanskom i srpskom jeziku u selu Binač.**
3. **Pod razno.**

Da li ima predloga za izmenu i dopunu dnevnog reda ili se slažete da dnevni red bude ovakav kako je? Ukoliko nema predloga za izmenu i dopunu dnevnog reda, stavljam dnevni red na usvajanje. Ko je za? Konstatujem da je dnevni red jednoglasno usvojen.

Prva tačka dnevnog reda:

1. **Razmatranje i usvajanje zapisnika sa pete sednice Komiteta za zajednice**

Materijal ste blagovremeno primili u Viber grupi, tako da je svako od nas mogao da pogleda i pročita zapisnik. Ako imate neke primedbe u odnosu na zapisnik, možete da ih iznesete ili da se glasanjem izjasnimo da usvojimo ovaj zapisnik. Da li ste za to da usvojimo zapisnik? Konstatujem da je zapisnik jednoglasno usvojen. Prelazimo na drugu tačku dnevnog reda.

Druga tačka dnevnog reda:

2. **Razmatranje nefunkcionisanja zajedničkog sistema grejanja u dve škole sa nastavom na albanskom i srpskom jeziku u selu Binač.**

**g.Nenad Ilic:** Ja sam predlagač ove tačke dnevnog reda, pa bih hteo da vas upoznam sa problematikom koja postoji vezano za ovu tačku dnevnog reda. U selu Binču, škola koju pohađaju deca na albanskom jeziku i škola koju pohađaju deca na srpskom jeziku nalaze se u istom dvorištu, što znači da deca dele jedno školsko dvorište. U jednom školskom objektu, u podrumu školskog objekta, instaliran je sistem centralnog grejanja koji je povezan i za jednu i za drugu školu. Sistem je instaliran pre više od 7–8 godina i korišćen je samo jednu jedinu sezonu. Moja slobodna procena je da je taj sistem u vrednosti sigurno oko 10.000 evra. Ima peć ogromnog kapaciteta i sve je u veoma dobrom stanju. Verujem da je to bila neka donacija. Međutim, posle te jedne sezone sistem je prestao da se koristi, iz razloga, kako su rekli ljudi koji rade na grejanju, što sistem negde ispušta vodu, odnosno tečnost, i zbog toga nije za korišćenje. Onda su radnici škole, odnosno ljudi koji su zaduženi za grejanje, prešli na sistem grejanja gde u svakoj učionici imaju peć. To su peći koje su zaista zastarele. Moja devojčica pohađa jednu od tih škola, ali u albanskoj školi je situacija ista. Peći su veoma zastarele, a odžaci i dimnjaci su u veoma lošem stanju, čak se dešavalo da delovi otpadaju. To je zaista loše stanje. I sada imamo situaciju, koja, po mom mišljenju, postoji samo kod nas, gde imate sistem koji vredi oko 10.000 evra, a deca se greju na način koji je zastareo i neadekvatan. Nemam informacije da li su direktori tih škola preduzimali nešto po tom pitanju i da li su se obraćali opštinskim organima kako bi poslali ekipu koja bi pregledala sistem i obezbedila deci grejanje onako kako treba, kvalitetno i bezbedno. Ovo nije samo pitanje komfora, već i bezbednosti. Mogli biste da se uverite i na slikama kako izgledaju te peći. One dime i kvalitet vazduha u učionicama sigurno nije dobar. Ukoliko zaista ne postoji nikakav zahtev od strane te dve škole da su se obratile Opštini i zatražile da se proveri kvar, onda zaista kritikujem njihov rad. Imaju direktore škola i školske odbore i oni su mogli da reaguju i pre nas. Mi jesmo instanca koja sada reaguje, ali smatram da je ovaj problem mogao biti pokrenut i ranije. Uglavnom, situacija je sledeća: smatram da kvar nije takav da se ne može relativno lako otkloniti. To bi mogla da uradi ekipa koju bi nadležni organi poslali, koja bi utvrdila gde je kvar i šta je potrebno da se sistem ponovo stavi u funkciju. Moja slobodna procena je da kvar uopšte nije veliki i da sistem koji je instaliran, a koji je veoma vredan, samo propada ukoliko se ne koristi i ne održava. Ja sam ovim obrazloženjem hteo da približim Komitetu problem koji postoji. Sada bismo mogli da otvorimo zajedničku diskusiju i utvrdimo koja bi rešenja mi kao Komitet mogli da predložimo i koje preporuke možemo da donesemo. Da li neko želi da uzme reč po ovoj tački dnevnog reda?

**g.Elhami Emërllahu:** Dugo sam radio u prosveti i to je veoma osetljiv posao, jer se uvek radi sa učenicima i školama. Koliko ja znam, više nema škola na teritoriji opštine Vitina koje se greju na peći. Dešavalo se da su povremeno imali problema sa sistemima grejanja u školama, ali su ti sistemi funkcionisali i još uvek funkcionišu. Jedan deo škola se greje na električnu energiju, jedan deo na drva, a neke su sa naftu. Opština Vitina ima ekipu koja nadgleda ove sisteme ili da nije za to zadužen samo jedan radnik. Ja ne znam kako je organizovana škola u Binču, da li tamo postoji direktor škole ili kako je to organizovano?

**g.Nenad Ilić:**Pošto su obrazovanja na Kosovu još uvek dva odvojena sistema, postoji direktor ispred albanskog sistema i direktor škole ispred srpskog sistema. I zato i ja postavljam pitanje, voleo bih njima da postavim pitanje, da li se nekad neko od direktora obratio nekoj instituciji za ovaj problem? Svakako da se kvarovi na sistemu grejanja dešavaju, ali međutim, sistem je dugo više van upotrebe. Ja razgovaram sa radnicima koji se bave loženjem. Nekima je lakše da ložu ovako. Znate, da bi radili kao ložač, morate da imate određene sertifikate. Možda čak i radnici na grejanju nemaju određene sertifikate.

**g.Elhami Emërllahu:** Bez obzira na to kakva je sada ta škola i što funkcioniše po dva sistema, mislim da, pošto je Opština već uspostavila sistem, ona treba i da ga uredi i obezbedi njegovo funkcionisanje. Bez obzira na sve, oni su građani Opštine Vitina, bilo da su Srbi ili Albanci.

**g.Nenad Ilić:** Ja nisam upoznat da je neka ekipa dolazila. Radio sam određeno vreme u jednoj od tih škola i razgovarao sam na tu temu. Međutim, da vi vidite peć i da vidite sistem, koliko je to zapravo dobro i koliko je kvalitetno, a ne koristi se, stvarno je šteta. Peć, koliko sam primetio, ima snagu od 70 kW, što je fantastično da pokrije oba objekta. I to u podrumu stoji i ne koristi se, kao neki alat koji odložite i tako propada. Samo da pogledate, možda možete kao članovi Komiteta da se i vi uverite i vidite kako zapravo izgledaju te peći, da pogledate taj sistem, kako je instaliran i čemu služi, ukoliko mi imamo ovlašćenja da posetimo škole.

**g.Elhami Emërllahu:** Onda je dobro da i mi, kao Komitet, pokrenemo ovo pitanje i da ti direktori dođu i podnesu zahtev Direkciji za obrazovanje, kako bi se sistem stavio u funkciju, pošto smo na letnjoj sezoni da bi bilo spremno od septembra.

**g.Nenad Ilić:** To bih, ukoliko usvojimo preporuku, ja kao predsedavajući uputio jedan zahtev kako nadležnim opštinskim organima, tako i direktorima škola.

**g.Rifat Aniqi:** Ako je potrebno, mogu biti prisutna i oba direktora na sednici kako bismo saznali u čemu je problem. Oni nam mogu mnogo bolje objasniti u čemu je problem.

**g.Nenad Ilić:** Ono što sam primetio jeste da te dve škole funkcionišu u fantastičnom ambijentu i koriste istu šupu za drva. Nije bitno odakle drva dolaze niti ko ih kupuje.

**g.Elhami Emërllahu:** Ovo mi se svida, jer je možda ovo jedini takav slučaj na Kosovu. Da se ne vraćam na ono što sam rekao prošlog meseca. Ne mogu da ćutim, a želeo bih da ovom gospodinu iz UNMIK-a kažem da, kada se rade izveštaji, oni treba da budu realni i da odražavaju stvarno stanje na terenu. Kada je reč o izveštajima o poštovanju prava zajednica na Kosovu, treba uzeti u obzir da i srpska i albanska zajednica imaju svoja prava. Bez obzira na to što srpska zajednica funkcioniše po sistemu Srbije, naša država toleriše i priznaje određena prava koja su možda osnovna. Ne želim da ulazim u politiku, ali da li je u redu ili nije u redu da funkcionišu dva sistema, to je sasvim drugo pitanje i nije naš posao. Međutim, mi kao Komitet treba da izvršimo pritisak da se taj sistem grejanja uredi i osposobi za normalno funkcionisanje.

**g.Nenad Ilić:** Svakako ovo je minimum. Čak i taj kvar, mi znamo da se dešavaju kvarovi, kvarovi se otklanjaju i nastavlja se sa funkcionisanjem, ali ne ovde, ovde je stalno. Škola je na brdu, hladno je i nakon sezone grejanja, međutim tamo se greju do kraja maja. Nemaju problema sa drvima. Da li još neko želi da uzme reč? Ukoliko ne, da li se slažete da Komitet za zajednice, kao što je i Elham predložio, pošalje preporuku nadležnim opštinskim organima i direktorima škola za hitno rešavanje problema do kraja ove sezone? Preuzimam odgovornost i grešku na sebe što na ovom sastanku nisam uputio poziv direktorima tih škola, pa bismo onda njima uputili neka pitanja koja smo dužni da postavimo. Da li se slažete da donesemo zaključke? Hvala. Eto, ja kao predsedavajući ću uputiti ovu preporuku i nadam se da ćemo uspeti da rešimo ovaj problem. Prelazimo na treću tačku dnevnog reda.

Treća tačka dnevnog reda:

3. **Pod razno.**

**g.Nenad Ilić:** Možda možemo sada da se dogovorimo o terminu za održavanje sednice u avgustu, kako bi svima odgovaralo zbog sezone odmora. Meni je svejedno, kako se vi dogovorite. A dnevni red možete da predložite. Ja bih vas zamolio da date neki predlog.

**g.Elhami Emërllahu:** Pošto smo kod tačke "razno", da li ima nešto novo u vezi sa zahtevom koji ste podneli Direkciji za javne službe u vezi sa putem?

**g.Nenad Ilić:** Još uvek nismo dobili nikakav odgovor od strane nadležnih institucija.

**g.Elham Emërllahu:** I još jedno pitanje, tražio bih da se ove sednice Komiteta koje se održavaju, zajedno sa dnevnim redom, objavljuju na internet stranici Opštine, jer ono o čemu razgovaramo, odluke koje donosimo, kao i naši predlozi i ideje, treba da budu dostupni i javnosti. Neka i Opština, predsednik Opštine i svi ostali znaju o čemu razgovaramo, kakve stavove zauzimamo i kakve zahteve upućujemo. Takođe, i pitanje naknada povremeno predstavlja problem. Ne znam zbog čega, ali i to bi trebalo da razjasnimo.

**g.Nenad Ilić:** Slažem se, dobar je predlog. Mi pretpostavljamo da znamo sve probleme, ali, međutim, neko bi nam se možda javio sa određenim preporukama za dnevni red, neko od građana.

**gđa. Antoneta Palja:** Što se tiče isplata, bavim se tim pitanjem, ali mi niko ne daje konkretan odgovor. Problem je u tome što je Ministarstvo poslalo dopis, kako mi je Fatlum rekao, ne znam kome, njemu ili predsedavajućem Skupštine, da se isplate koje su se do sada vršile iz koda za plate i naknade prebace sa tog koda i da se sredstva uzmu sa drugog koda. Međutim, kada sam pitala Beqira, kome predajem spisak, on mi je rekao da treba da se podnese zahtev preko eKosove, ali nije znao da mi objasni gde, odnosno u kojoj rubrici. Pitala sam i Vloru iz Finansija. Ona mi je prvo rekla da jedan od članova treba da preuzme odgovornost da mu se sredstva uplate, a da ih on potom raspodeli ostalim članovima. Međutim, to nema logike, jer su članovi

pojedinačno korisnici tih naknada. Takođe sam joj postavila pitanje kako su to rešili sa KPF-om, pošto su oba komiteta obavezna komiteta, i smatram da, ako se na jedan način postupa sa jednim komitetom, trebalo bi na isti način postupati i sa drugim. Onda mi je rekla: "Neka podnesu zahtev preko eKosove i daju mi broj zahteva", ali ni to mi nisu objasnili kako se konkretno radi.

**g.Visar Demiri:** Ja ne znam, ovo je apsurdno. Kao prvo, ovo su tela koja bira Skupština opštine i ovakvim načinom se više pravi šteta, jer je protivzakonito da se sredstva uplaćuju jednoj osobi, a da ih ona zatim raspodeljuje ostalima. Trebalo bi da zatraže pojašnjenje od Ministarstva finansija i Ministarstva lokalne samouprave. Ako možeš, traži da nam taj zahtev odnosno dopis pošalju u grupu, kako bismo videli na šta se tačno pozivaju i na osnovu kog zakona postupaju.

**g.Nenad Ilić:** Da li opštinski organi rade na rešavanju ovog problema ili je to odgovor viših instancija, pa sada sve ovako stoji? Jer nas je ovde postavila Opština, mi odgovaramo Opštini i onda odgovore treba da tražimo od njih.

**g.Elhami Emërllahu:** Neke opštine plaćaju samo skupštinske odbornike, to zavisi od toga kako je Opština to uredila. Opština Vitina nije imala taj problem, mi smo dobijali naknade

**g.Visar Demiri:** To je kršenje ljudskih prava kada neko ko obavlja isti posao prima naknadu, dok neko drugi za isti posao nije plaćen.

**g.Nenad Ilić:** Da li se slažete da svakako pozovemo ili predsednika Skupštine ili Fatluma, pa da nam i on detaljno objasni situaciju i da zajedno sa njim izvedemo zaključke o tome šta bi trebalo da radimo?

**g.Visar Demiri:** Razgovaraću sa predsedavajućim i Fatlumom. Ako imaju imejl, uzeću ga od njih.

**g.Elhami Emërllahu:** Nismo samo mi, ni članovi KPF-a takođe nisu plaćeni.

**g.Visar Demiri:** To je drugi problem. Problem je u tome što se ove naknade isplaćuju iz sopstvenih prihoda Opštine, a izvršitelj ta sredstva uzima. Što se tiče KPF-a, svi članovi su ujedno i članovi Skupštine, dok su kod nas samo troje članova iz Skupštine. Za nas to nije problem, ali za članove koji nisu deo Skupštine je problem.

**g.Nenad Ilić:** Ukoliko nema niko više ništa da doda, zahvaljujem vam se na prisustvu i vidimo se na sledećem sastanku.

**Sednica je završena u 11:37 časova.**

**Zapisničarka:**
**gđa.Antoneta Palja**

____________

**Predsedavajući Komiteta za zajednice**
**g.Nenad Ilić**

____________